

PROGRAM I PËRBASHKËT STUDIMI BACHELOR NË “MENAXHIM I TURIZMIT TË QËNDRUESHËM”

Emërtimi akademik i studimit	Diplomë e Dyfishtë Bachelor në Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm.
Statusi i Akreditimit të programit të studimit	Ne proces akreditimi
Cikli i studimit	Cikli i parë i studimeve
Emri dhe statusi i institucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Fakulteti Ekonomik , Institucion Publik, Akredituar
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqipe/Angleze
Kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit	3 (tre) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	a.Pranimi në këtë program studimi, është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm të përgjithshëm apo profesional dhe që plotëson kriterin e notës mesatare, të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. b. Në këtë program studimi, pranohen edhe ata kandidatë, të cilët kanë marrë një diplomë të shkollës së mesme të fituar jashtë vendit, për të cilën kërkohet njehësimi nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. c.Pranimi i studentëve për këtë program studimi kryhet nëpërmjet Maturës Shtetërore (portali U-albania). <i>Përlllogaritja 50% nota mesatare aritmetike e shkollës së mesme përfshirë dhe provimet e Maturës Shtetërore dhe 50% gruplëndët e përcaktuara nga fakulteti për disiplinat bërthamë (për të gjitha vitet ku shtrihet lënda).</i>

OBJEKTIVAT DHE VEPRIMTARITË FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi i programit të përbashkët të studimeve (diplomë e dyfishtë) në **Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm** është të ofrojë një formim të plotë në fushën e turizmit, që do të shërbejë në aspektin e punësimit në tregun lokal, rajonal, kombëtar edhe më gjerë. Gjithashtu, përcaktohet dhe vlerësohet në kuadër të ndryshimeve ekonomiko-shoqërore të vendit dhe rajonit në përgjithësi, përshtatjes së kërkesave të tregut turistik, nevojës për të qenë pjesë aktive e tij, si dhe domosdoshmërisë për specialistë të fushës së turizmit, të aftë për zgjidhjen e problemeve në këtë sektor në kuadër të zhvillimeve të vullshme të industrisë turistike.

Ky program i pajis studentët e mobilitetit me dy diploma të lëshuara nga Universiteti i Gjirokastrës “Eqrem Çabej” dhe Univeristetit të Molises, Itali sipas kushteve të marrëveshjes specifike midis dy universiteteve. Në përfundim të tij fitohet : Diplomë Bachelor në “Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm”.

Gjithë procesi akademik udhëhiqet nga disa objektiva të përcaktuara qartë duke synuar:

1. Përgatitjen e profesionistëve të ardhshëm me njohuritë e duhura bazë turistike, ekonomike dhe praktike në fushën e turizmit nëpërmjet ofrimit të një mësimdhënieje bashkëkohore duke integruar teorinë me praktikën dhe rastet studimore;
2. Aftësimin e studentëve për tregun e punës dhe përgatitjen për karrierat e mëtejshme respektive;
3. Formimin e specialistëve me njohuritë e nevojshme për menaxhimin e sipërmarrjeve turistike;
4. Formimin e specialistëve me njohuritë e nevojshme për menaxhimin e resurseve turistike, ruajtjes së trashëgimisë kulturore lokale;
5. Formimin e specialistëve si zhvillues e promovues të politikave të përfshirjes së komuniteteve lokale në funksion të zhvillimit rajonal.

Figura profesionale bazë që formohet nëpërmjet këtij programi është ajo e specialistit në sektorin e turizmit dhe institucioneve dhe ndërmarrjeve që operojnë në këtë sektor.

Objektivat e përmendura më lart dhe të tjera aftësi që ky program synon të arrijë me studentët që ndjekin këtë cikël studimi, do të sigurojë një performancë sa më të lartë në mjedisin në të cilin do të operojë si i punësuar në të ardhmen.

VEPRIMTARITË FORMUESE

1. Lëndë të formimit të përgjithshëm

Nr	Lëndët	Kredite
1.	Hyrje në Ekonomi	6
2.	Historia e Ekonomisë	6
3.	Bazat e Turizmit	6
4.	Bazat e Marketingut	6
5.	Menaxhim Biznesi	6
6.	Mikroekonomi	6
	TOTALI	36

2. Lëndë të formimit karakterizues

Nr	Lëndët	Kredite
1.	Parimet e Menaxhimit të Turizmit të Qëndrueshëm	6
2.	Makroekonomi	6
3.	Parimet e Kontabilitetit	6
4.	Kontabiliteti Financiar	7
5.	Manaxhimi i Burimeve Njerëzore	6
6.	Marketingu Turistik	6
7.	Manaxhimi Shërbimit të ushqimit dhe Pijeve	6
8.	Financa Publike	6
9.	Etika e Biznesit	6
10.	Sjellje Organizative	6
11.	Strategjia e Turizmit	6
12.	Drejtimi i Ndërmarrjeve Turistike	6
13.	Gjeografia e turizmit: Trashëgimia dhe qëndrueshmëria	7
14.	Hoteleri dhe restoranti	6
15.	Turizmi kulturor dhe trashëgimia	6
	TOTALI	92

3. Lëndë ndërdisiplinore/ integruese lëndë–nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje

Nr	Lëndët	Kredite
1.	Turizmi dhe promovimi i peizazhit	6
2.	Statistikë	6
3.	Lëndë me zgjedhje (1 nga 3)	5
	1)Shkrim akademik	
	2)Strategji marketingu	
	3)Shkrim dhe menaxhim projektesh	
4.	Lëndë me zgjedhje (1 nga 3)	5
	1)Kontabilitet kosto drejtimi	
	2)Kontabilitet nacional	
	3)Financa personale	
5.	Lëndë me zgjedhje (1 nga 3)	5
	1)Biznes ndërkombëtar	
	2)Investime	
	3)Drejt看 marketingu	
	TOTALI	27

4. Lëndë të formimit plotësues

Nr	Lëndët	Kredite
1.	Gjuhë e Huaj (Anglisht, Frëngjisht, Italisht)	6
2.	Informatikë	6
3.	Praktikë profesionale	6
	TOTALI	18

5. Përgatitje punim diplome

Nr	Lëndët	Kredite
1.	Provim formimi/ Punim diplome	7
	TOTALI	7

SKEMA E VLERËSIMIT

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem notash nga 1 deri në 10, ku notat kanë kuptimin e mëposhtëm : 1-4 (mbetës), 5 (mjaftueshëm), 6 (kënaqshëm), 7-8 (mirë), 9 (shumë mirë), 10 (shkëlqyer).

Gjatë provimit aplikohet një sistem pikësh, rezultatet e të cilave konvertohen në nota bazuar në skemën e mëposhtme:

NOTA	PIKËT
4 (katër)	0 në 44 pikë
5 (pesë)	45 - 54 pikë
6 (gjashtë)	55 - 64pikë
7 (shtatë)	65 - 74 pikë
8 (tetë)	75 – 84 pikë
9 (nëntë)	85 – 94 pikë
10 (dhjetë)	95 – 100 pikë

MUNDËSIA PËR STUDIME TË MËTEJSHME

Diploma juaj e ciklit të parë “Bachelor” në **Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm** është ura lidhëse e zhvillimit të mëtejshëm akademik dhe profesional drejt cikleve më të larta të studimit. Kurrikula jonë është e dizenuar në mënyrë të tillë që të ofrojë formate fleksible të të mësuarit duke zgjeruar gradat dhe specializimet e nevojshme. Gjithashtu, pajisja me diplomë të dyfishtë të lëshuara nga Universiteti i Gjirokastrës “Eqrem Çabej” dhe Univeristetit të Molises, Itali çel rrugë të reja dhe mundësi punësimi në tregjet evropiane. Prandaj detyra jonë më e rëndësishme është përgatitja e studentëve për sfidat dhe mundësitë që ofron punësimi në sektorin turistik.

Studenti i cili diplomohet në programin e studimit Bachelor në **Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm** mundet të vazhdojë studimet në një program të ciklit të dytë të studimeve Master Profesioanl apo Master i Shkencave në turizëm apo në një fushë të ngjajshme, bazuar në kriteret e vendosura nga Njësia bazë, sikurse edhe orientimi dhe preferenca e studentit.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT DHE KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

Gjithnjë e më shumë tregu i punës po kërkon specialistë në sektorin turistik. Nëpërmjet këtij programi synohet formimi shkencor dhe profesional i studentëve që të bëhen drejtues, specialistë dhe konsulentë të aftë në sektorin turistik. Pas përfundimit të studimeve i diplomuari duhet të jetë i pajisur me:

- Njohuri themelore për sektorin dhe industrinë turistike.
- Njohuri për menaxhimin dhe drejtimin e bizneseve turistike dhe bizneseve ndihmëse të turizmit.
- Njohuri për format e turizmit, traditat, kulturën, historinë, monumentet e natyrës, dhe rëndësinë e tyre në zhvillimin turistik të një destinacioni.
- Njohuri të nevojshme në fushën e menaxhimit, promovimit dhe zhvillimit të një destinacioni turistik.
- Njohuri për praktikat dhe procedurat më bashkëkohore të shërbimit ndaj turistëve.
- Mundësi bashkëpunimi me specialistë të njohur të fushës së turizmit.

Në përfundim të këtij programi, studenti ka mundësi për punësim si:

- Në sipërmarrje private turistike
- Në biznese që ofrojnë shërbime turistike
- Në biznese ndihmëse turistike
- Në zyra dhe agjensi turistike
- Në sektorin publik

Studenti i cili diplomohet në programin e studimit Bachelor në **Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm** mundet të vazhdojë studimet në një program të ciklit të dytë të studimeve.

DETAJET E PROGRAMIT TË STUDIMIT**Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm**

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithsej	Semestri
Viti i parë				
1.	Hyrje në ekonomi	6	75	I
2.	Histori e ekonomisë	6	45	I
3.	Bazat e Turizmit	6	60	I
4.	Bazat e marketingut	6	60	I
5.	Menaxhim biznesi	6	60	II
6.	Turizmi dhe promovimi i peizazhit	6	75	II
7.	Parimet e Menaxhimi të Turizmit të Qëndrueshëm	6	60	II
8.	Mikroekonomi	6	60	I
9.	Gjuhë e huaj (Anglisht, Frëngjisht, Italisht)	6	60	II
10.	Statistikë	6	75	II
Gjithsej viti i parë		60	630	

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithsej	Semestri
Viti i dytë				
1.	Makroekonomi	6	75	I
2.	Parimet e kontabilitetit	6	60	I
3.	Kontabiliteti Financiar	7	75	II
4.	Menaxhim i Burimeve Njerezore	6	60	I
5.	Marketingu Turistik	6	60	I
6.	Menaxhimi i Shërbimit të Ushqimit dhe Pijeve	6	60	II
7.	Financa publike	6	60	II
8.	Etika e biznesit	6	60	II
9.	Informatike	6	45	I
10.	Lende me zgjedhje:			
	-Shkrim akademik - Strategji marketingu - Shkrim dhe menaxhim projektesh	5	45	II
Gjithsej viti i dytë		60	600	

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithsej	Semestri
Viti i tretë				
1.	Sjellje Organizative	6	60	I
2.	Strategjia e Turizmit	6	60	II
3.	Drejtimi i ndërmarrjeve turistike	6	60	I
4.	Gjeografi e Turizmit: Trashëgimia dhe Qëndrueshmëria	7	75	I
5.	Hoteleri dhe Restoranteri	6	60	II
6.	Turizmi Kulturor dhe Trashëgimia	6	60	I
7.	Praktikë Profesionale	6	60	II
8.	Lëndë me zgjedhje:			
	-Kontabilitet Kosto Drejtimi -Kontabilitet Nacional -Financa Personale	5	45	I
9.	Lëndë me zgjedhje:			
	-Biznes Ndërkombëtar -Investime -Drejtim Marketingu	5	45	II
10.	Provim Formimi/Punim Diplome	7	50	II
Gjithsej viti i tretë		60	575	
Total : Viti I + Viti II + Viti III		180	1805	